



REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMIJA PRAVDE - ACADEMY OF JUSTICE			
Njësia, Org. Org. Jedin. Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	219
Nr. Faqeve Nr. Stranica No. Pages	1	Data Datum Date	20.09.2017
Prishtinë / a			



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademia Pravde/Academy of Justice

Nr. 01/219/2017
Datë: 12/09/2017

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, në bazë të nenit 11 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-095, për Akademinë e Drejtësisë, dhe nenit 18 të Rregullores Nr.02/2017 për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, në mbledhjen e pestë të përbërjes së parë, të mbajtur më 12 shtator 2017, nxjer këtë:

V E N D I M

1. Miratohet procesverbali i takimit të katërt (4) të Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, i mbajtur me datë 18 korrik 2017.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.




Aleksandër Lumezi

Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

Arkivit të Akademisë së Drejtësisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Nr. 01/220/2017

Datë: 12/09/2017

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, në bazë të nenit 11 paragrafi 4 dhe nenit 25 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 05/L-095, për Akademinë e Drejtësisë dhe nenit 14 të Rregullores Nr.06/2017 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë, Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës Nr. KGJK, nr. 250/2017 të datës 09.08.2017, në mbledhjen e pestë të përbërjes së parë, të mbajtur më 12 shtator 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohen Mentorët të cilët do të angazhohen për të mentoruar gjyqtarët e sapoemëruar, në trajnimin fillestar, sipas propozimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
2. Mentorët e emëruar janë gjyqtarë nga Departamenti i Përgjithshëm i gjykatave themelore me mandat të përhershëm si në vijim:

2.1 Mentor të gjyqtarëve të sapoemëruar në Gjykatën Themelore Prishtinë janë si në vijim:

- 2.1.1 Anita Krasniqi-Prenaj, mentore për lëmin penale;
- 2.1.2 Naser Foniqi, gjyqtar, mentor për lëmin penale;
- 2.1.3 Naime Krasniqi-Jashanica, mentore për lëmin penale;
- 2.1.4 Rrustem Begolli, mentor për lëmin penale;
- 2.1.5 Drita Rexhaj, mentore për lëmin civile;
- 2.1.6 Faton Bajrami, mentore për lëmin civile;
- 2.1.7 Halide Reka, mentore për lëmin civile;
- 2.1.8 Hasim Sogojeva, mentor për lëmin civile;
- 2.1.9 Lekë Prenaj, mentor për lëmin civile;
- 2.1.10 Latif Xhenajli, mentor për lëmin civile;
- 2.1.11 Saranda Boga-Sheremeti, mentore për lëmin civile;
- 2.1.12 Enver Shabanaj, mentor për lëmin civile;
- 2.1.13 Shefqet Baleci, mentor për lëmin penale;
- 2.1.14 Daut Behrami, mentor për lëmin civile;
- 2.1.15 Gazmend Bahtiri, mentor për lëmin penale;
- 2.1.16 Minir Hoti, mentor për lëmin penale;
- 2.1.17 Bujar Muzaqi, mentor për lëmin civile;
- 2.1.18 Binak Duqi, mentor për lëmin civile;
- 2.1.19 Avdirrahman Gashi, mentor për lëmin penale;
- 2.1.20 Zenel Tasholli, mentor për lëmin civile.

2.2 Mentor të gjyqtarëve të sapoemëruar në Gjykatën Themelore Prizren janë si në vijim:

- 2.2.1 Vatton Totaj, mentor për lëmin civile;
- 2.2.2 Lumni Sallauka, mentor për lëmin civile;
- 2.2.3 Shaban Shala, mentor për lëmin civile;
- 2.2.4 Edije Sezairi, mentor për lëmin civile;
- 2.2.5 Teuta Krusha, mentore për lëmin penale;
- 2.2.6 Refki Piraj, mentor për lëmin penale;
- 2.2.7 Sadije Selmani, mentore për lëmin penale;
- 2.2.8 Luan Berisha, mentor për lëmin penale;
- 2.2.9 Robert Tunaj, mentor për lëmin penale;
- 2.2.10 Qemal Suka, mentor për lëmin penale;
- 2.2.11 Nuredin Abazi, mentor për lëmin civile;
- 2.2.12 Shaban Zeqiraj, mentor për lëmin civile.

2.3 Mentor të gjyqtarëve të sapoemëruar në Gjykatën Themelore Pejë janë si në vijim:

- 2.3.1 Violete Husaj -Rugova, mentore për lëmin penale;
- 2.3.2 Afërdita Mulhaxha, mentore për lëmin civile;
- 2.3.3 Ganimete Kukaj-Ibraj, mentore për lëmin civile;
- 2.3.4 Fatmir Baloku, mentor për lëmin civile;
- 2.3.5 Merita Baloku, mentore për lëmin civile;
- 2.3.6 Armend Berisha, mentor për lëmin civile;

2.4 Mentor të gjyqtarëve të sapoemëruar në Gjykatën Themelore Gjilan janë si në vijim:

- 2.4.1 Islam Thaçi, mentor për lëmin penale;
- 2.4.2 Behar Imeri, mentor për lëmin penale;
- 2.4.3 Berat Spahiu, mentor për lëmin civile;
- 2.4.4 Halil Sezairi, mentor për lëmin civile;
- 2.4.5 Mevlide Shabani, mentore për lëmin civile.

2.5 Mentor të gjyqtarëve të sapoemëruar në Gjykatën Themelore Mitrovicë janë si në vijim:

- 2.5.1 Faton Ademi, mentor për lëmin civile;
- 2.5.2 Hajrullah Aruqi, mentor për lëmin civile;
- 2.5.3 Besnik Feka, mentor për lëmin civile;
- 2.5.4 Liridon Maloku, mentor për lëmin civile;
- 2.5.5 Mentor Hajra, mentor për lëmin penale;
- 2.5.6 Rifat Bllata, mentor për lëmin penale.

2.6 Mentor të gjyqtarëve të sapoemëruar në Gjykatën Themelore Gjakovë janë si në vijim:

- 2.6.1 Ilir Rashkaj, mentor për lëmin penale;
- 2.6.2 Jonuz Bugari, mentor për lëmin civile;
- 2.6.3 Lulzim Paçarizi, mentor për lëmin penale;
- 2.6.4 Nehat Qelaj, mentor për lëmin civile.

2.7 Mentor të gjyqtarëve të sapoemëruar në Gjykatën Themelore Ferizaj janë si në vijim:

- 2.7.1 Rizah Livoreka, mentor për lëmin civile;
 - 2.7.2 Enis Mehmeti, mentor për lëmin civile;
 - 2.7.3 Faton Ajvazi, mentor për lëmin penale;
 - 2.7.4 Adem Shabani, mentor për lëmin penale;
 - 2.7.5 Burim Emerllahu, mentor për lëmin civile;
 - 2.7.6 Shabi Idrizi, mentor për lëmin penale;
3. Mandati i mentorëve të emëruar përfundon, me përfundimin e trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapoemëruar që janë në programin e trajnimit fillestar, nëse gjatë kohës së trajnimit fillestar ndryshon funksionin e tij si gjyqtar, nëse kalon nga niveli themelor në nivele tjera të gjykatës, apo kalon nga Departamenti i Përgjithshëm në departamente tjera.
4. Mentorët angazhohen për të zbatuar programin e trajnimeve praktike 6 muaj në fushën penale dhe 6 muaj në fushën civile.
5. Në gjykatat ku numri i gjyqtarëve në Departamentin e Përgjithshëm është më i vogël se numri i gjyqtarëve në trajnim, Mentorëve mund t'iu caktohen më shumë se një kandidat në trajnim.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Aleksandër Lumezi


Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë

Kopja e vendimit i dërgohet:

Arkivit të Akademisë së Drejtësisë
Mentorëve të emëruar



REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMIJA PRAVDE - ACADEMY OF JUSTICE			
Njësia, Org. Org. Jedin. Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	221
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	1	Data Datum Date	20.09.2017
Prishtinë / a			



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Nr. 01/221/2017
Datë: 12/09/2017

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, në bazë të nenit 11 paragrafi 4 dhe nenit 25 paragrafi 3, të Ligjit Nr.05/L-095, për Akademinë e Drejtësisë si dhe nenit 15 paragrafi 4 i Rregullores Nr.06/2017 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë, në mbledhjen e pestë të përbërjes së parë, të mbajtur më 12 shtator 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e kompensimit për mentorët në Trajnimin Fillestar

1. Mentorët e angazhuar në Trajnimin Fillestar për gjyqtarët e sapoemëruar do të kompensohen në shumë prej 150 (njëqindpesëdhjetë) euro bruto në muaj.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e mentorëve janë të përcaktuara me aktet normative dhe me kontratë.
3. Vendimi vlen deri me datë 31 dhjetor 2017. Pas vlerësimit të buxhetit të Akademisë, Këshilli Drejtues do të marrë vendim për përcaktimin e shumës së kompensimit të mentorëve për vitin 2018.
4. Udhëzohet Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi sipas ligjeve dhe rregullave për procedim të pagesave.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Aleksandër Lumezi


A. Lumezi
Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë

Kopja e vendimit i dërgohet:

Mentorëve të Akademisë
Arkivit të Akademisë së Drejtësisë



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMIJA PRAVDE - ACADEMY OF JUSTICE			
Njësia, Org. Org. Jedin. Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	222
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	1	Data Datum Date	20.09.2017
Prishtinë / a			



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Nr. 01/222/2017

Datë: 12/09/2017

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë në bazë të nenit 10 paragrafi 1, nën paragrafi 1.9, nenit 11 paragrafi 4 dhe nenit 18 paragrafi 1, nën paragrafi 1.5, paragrafit 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, si dhe nenit 6, 7, 13 paragrafi 3 dhe nenit 14 të Rregullores Nr. 01/2017 për Procedurën e Emërimit dhe Shkarkimit të Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë, shqyrtoi ankesën e kandidatit Ramadan Gashi, kundër Komisionit Përzgjedhës për shkak të mos përfshirjes në listën e ngushtë për pozitën Drejtor Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë, në mbledhjen e katërt të përbërjes së parë, të mbajtur më 18 korrik 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar, ankesa e kandidatit Ramadan Gashi, e paraqitur kundër Komisionit Përzgjedhës për shkak të mos përfshirjes në listën e ngushtë për pozitën Drejtor Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë.

A r s y e t i m

Ankuesi Ramadan Gashi ka aplikuar në konkursin me Nr. Reference 01/01/ZD-AD i shpallur nga Akademia e Drejtësisë me datë 26.07.2017, për pozitën "Drejtor Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë".

Duke qenë i pakënaqur me njoftimin e datës 05/09/2017 me të cilin njoftohet se nuk është përfshirë në listën e ngushtë të kandidatëve, kandidati Ramadan Gashi brenda afati ligjor ka parashtruar ankesë Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, për shkak të mos përfshirjes në listën e ngushtë për pozitën Drejtor Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë, nga ana e Komisionit Përzgjedhës me pretendimin se "Komisioni Përzgjedhës ka qenë i njëanshëm, ka zbatuar jo drejt faktet dhe dispozitat, me çka ka bërë shkelje absolute të dispozitave ligjore materiale dhe procedurale si dhe ka vlerësuar gabimisht dhe jo drejtë gjendjen faktike".

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë me datë 12 qershor 2017 ka shqyrtuar ankesën dhe provat e bashkëngjitura në ankesë si: "Certificate for the successful completion of the training program on four Core Competency seminars - Casflow Mnagement and Information Technology in the Courts" e lëshuar nga Justice Reform Activity, "Certificate

for the successful completion of the Court Management Manual Training of Trainers” e lëshuar nga Kosovo Justice Support Program, “Certifikatën për pjesëmarrjen në trajnimin Aftësitë e shkruarjes së raporteve”, e lëshuar nga IGJK, GIZ dhe MDA, “Certificate for attended and completed the Training Course Creative Thinking&Problem Solving” e lëshuar nga OSBE si dhe “Mission Report” i lëshuar nga Further Support to Kosovo Legal Education Reform, po ashtu ka dëgjuar edhe Kryetarin e Komisionit Përzgjedhës për Zgjedhjen e Drejtorit Ekzekutiv, dhe ka konstatuar se ankesa e kandidatit Ramadan Gashi është e **pabazuar** dhe si e tillë është **refuzuar**.

Këshilli Drejtues ka shqyrtuar pretendimet e ankuesit të parashtruara në ankesë se:

- Komisioni Përzgjedhës në përbërje të njëjtë ka marrë pjesë dy herë në procedurën e rekrutimit, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi;
- Komisioni Përzgjedhës ka shkelur afatet procedurale rreth vlerësimit të aplikacioneve;
- Procedura e rekrutimit të Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë është dashur të jetë procedurë e brendshme, e jo procedurë e jashtme për t’iu krijuar hapësirë kandidatëve të jashtëm;
- Komisioni Përzgjedhës ka nënvlerësuar pozitën e trajnuesit gjyqësor, nivelin e gradës, trajnimet e ndjekura si dhe trajnimet që ai ka mbajtur për gjyqtarë dhe prokurorë gjatë ushtrimit të funksionit të tij si trajnues gjyqësor;

Këshilli Drejtues, gjatë shqyrtimit të ankesës ka konstatuar se pretendimi i ankuesit se Komisioni Përzgjedhës në përbërje të njëjtë ka marrë pjesë dy herë në procedurën e rekrutimit në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, nuk qëndron për faktin se Komisioni Përzgjedhës është formuar në përputhje të plotë me nenin 7 të Rregullores Nr. 01/2017 për Procedurën e Emërimit dhe Shkarkimit të Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë. Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë në mbledhjen e mbajtur me datë 18 korrik 2017 ka marrë vendim Nr. 01/181/2017 me të cilin është anuluar procesi i rekrutimit të Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë, dhe në të njëjtë kohë ka vendos që procedura e rekrutimit të filloj përsëri me rishpallje të konkursit. Po ashtu Këshilli Drejtues ka marrë vendim Nr. 01/183/2017 që të formoj Komisionin Përzgjedhës konform nenit 7 të Rregullores Nr. 01/2017 për Procedurën e Emërimit dhe Shkarkimit të Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë, duke rikonfirmuar përbërjen e njëjtë të Komisionit sipas nenit 7 par. 2 të Rregullores Nr. 01/2017 “Anëtarët e Komisionit Përzgjedhës nuk mund të jenë më shumë se dy herë radhazi anëtarë të Komisionit”, por në një proces të ri rekrutimi.

Lidhur me pretendimin e ankuesit për shkeljen e afateve procedurale, Këshilli Drejtues pas dëgjimit të Kryetarit të Komisionit, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës ka mbajtur takimin brenda afatit të përcaktuar me Rregullores Nr. 01/2017 për Procedurën e Emërimit dhe Shkarkimit të Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë, por për arsye objektive nuk ka arritur ta përfundoj procesin e vlerësimit të dokumentacionit të kandidatëve dhe të përgatisë listën e ngushtë të kandidatëve, prandaj ka caktuar një datë tjetër në të cilën do të përfundohej ky proces, kështu që Këshilli Drejtues nuk gjen se ka pasur shkelje të afateve siç është përcaktuar në rregullore.

Këshilli Drejtues ka vlerësuar se procedura e rekrutimit të Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë, është zhvilluar në përputhje dispozitat ligjore në fuqi, përkatësisht me nenin 18 par. 4 të Ligjit Nr. 05/L-95 për Akademinë e Drejtësisë “Procedura e përzgjedhjes së

Drejtorit Ekzekutiv bëhet nga Këshilli Drejtues mbi bazën e konkursit publik”, dhe nenit 18 par. 7 të Ligjit Nr. 05/L-95 për Akademinë e Drejtësisë “Procedura e përzgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv përcaktohet në detaje me akt nënligjor të miratuar nga Këshilli Drejtues, duke reflektuar parimet e shërbimit civil”, prandaj pretendimet e ankuesit se procedura e rekrutimit të Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë është dashur të jetë procedurë e brendshme, e jo procedurë e jashtme për t’iu krijuar hapësirë kandidatëve të jashtëm, nuk qëndrojnë pasi që ky proces është i përcaktuar qartë me Ligjin për Akademinë e Drejtësisë.

Këshilli Drejtues gjatë shqyrtimit të ankesës, lidhur me pretendimin e ankuesit se Komisioni Përzgjedhës ka nënvlerësuar pozitën e trajnuesit gjyqësor, nivelin e gradës, trajnimet e ndjekura si dhe trajnimet që ai ka mbajtur për gjyqtarë dhe prokurorë gjatë ushtrimit të funksionit të tij si trajnues gjyqësor, ka vlerësuar me kujdes edhe provat e prezantuara në ankesë, dhe ka konstatuar se Komisionit Përzgjedhës gjatë vlerësimit të dokumentacionit të ankuesit, ka vlerësuar drejtë dëshmitë mbi përvojën e punës dhe shkathtësive që posedon ankuesi. Këshilli Drejtues vlerëson se pretendimet e kandidatit se ai ka kryer trajnime të ndryshme për menaxhim si dhe ka mbajtur trajnime të tilla qoftë edhe për gjyqtarë e prokurorë nuk përbëjnë përvojë të punës menaxheriale, por kanë të bëjnë me shkathtësi të nevojshme për të kryer punë të caktuara, e të cilat nuk kanë qenë subjekt i vlerësimit, por as nuk janë kontestuar nga ana e Komisionit Përzgjedhës. Këshilli Drejtues ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës ka vlerësuar dokumentacionin e kandidatëve konform nenit 11 paragrafi 3 i Rregullores Nr. 01/2017 për Procedurën e Emërimit dhe Shkarkimit të Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë, “Për përgatitjen e listës së ngushtë *Komisioni duhet të verifikojë: 3.1 përmbushjen e kriterëve formale të përcaktuara me ligj; 3.2 dokumentet përkatëse që dëshmojnë kualifikimin e tyre; 3.3 verifikojë përvojën e kandidatëve; [..],* ndërsa parashtuesi i ankesës nuk ka ofruar dëshmi shtesë për përvojën menaxheriale të punës.

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, gjatë shqyrtimit të pretendimeve të parashtuesit të ankesës dhe të gjitha provave të prezantuara, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



Aleksandër Lumezi

Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:
Ankuesit Ramadan Gashi
Burimeve njerëzore të Akademisë së Drejtësisë
Arkivit të Akademisë së Drejtësisë